

PhD: Blerina Xhelaj

Pedagoge e jashtme, Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë

Pedagoge e jashtme, "Albanian University", filiali Fier

e-mail blerinaxhelaj@yahoo.com

June's revolution and his impact in Albania

Abstract

Is one of the most important and the interesting event of Albanian state during 1924. The most important figure that emerges in this period on the Albanian political arena was Fan Noli. He demanded the overthrowing of the government of Ahmet Zogu, where the later was the biggest opponent of Noli. According to Noli , Zogu was ruling Albania dictatorial views and features and was orienting it increasingly in the arms of her neighbor opponent Yugoslavia. During this time, Belgrade was constantly trying to get in Albania and some vital issues of concern to this country, for example, the issue of Shen- Naum, Vermoshi, establishing trade and custom relations among them etc. Noli sow the approach of Yugoslavia with Albania very threatening. On June 24, Noli, overthrew Ahmet Zogu, with the latter leaving in the direction of Belgrade. Noli creates the new government. The question arisen is: Weather Fan Noli came to power through a coup, or was it a revolution?

Revolucioni demokratik i qershorit

Revolucioni i Qershorit dhe qëndrimi i Jugosllavisë.

Në 10 qershor të vitit 1924, në Shqipëri shpërtheu Revolucioni i Qershorit, e cila ishte një ngjarje e shënuar historike, që do të çonte në rrëzimin e qeverisë së Zogut dhe zëvendësimin me një qeveri demokratike. Qeveria e re përbëhej nga njerëz intelektualë që përfaqësonin rrugën e progresit dhe të demokracisë, ku në programin e tyre politik kishin mbrojtjen e shtresave të ulta dhe të mesme. “Revolucioni sollti në fuqi qeverinë më demokratike në historinë e shtetit të pavarur shqiptar.”.[1] Qeveria e re u kryesua nga intelektual i njohur i kohës, që kishte vepruar në Shqipëri dhe jashtë saj, Fan Stilian Noli. Qeveria e re parashikonte ndryshime radikale në reformat që do të ndërmerrnin si: “ç’rrenjosjen e feudalizmit, vendosjen e demokracisë, reforma administrative ushtarake dhe legjislative, çlirimin e bujkut pakësimin e taksave për shtresat e ulta, mbrojtjen e ekonomisë nacionale nga kapitali i huaj organizimin e arsimit në baza nacionale, ngritjen e prestigjit të shtetit shqiptar në botën e jashtme, marrëdhënie miqësore me të gjithë shtetet etj.”.[2] Qeveria Noliste ishte për ruajtjen e marrëdhënieve të mira me të gjitha vendet evropiane dhe sidomos me ato fqinje.

Ai kishte nevojë dhe për ndihmë financiare. “Nevoja për mbështetje financiare e detyroi Nolin t’i drejtohej për ndihmë Lidhjes së Kombeve”.[3] Ajo e hodhi poshtë kërkesen e Nolit, sepse sipas tyre, ajo kishte ardhur në pushtet në mënyrë revolucionare. Noli kishte si synim njohjen e qeverisë së tij në arenën ndërkombëtare. Sipas tij kjo ishte qeveria më demokratike që kishte njohur ndonjëhere Shqipëria.

Noli u dërgoi një numër telegramesh Fuqive të Mëdha dhe fqinjëve të saj. Ajo i dergoi telegram edhe Lidhjes së Kombeve në 17 dhjetor të vitit 1924. Qeveritë e Fuqive të Mëdha nuk e njohën qeverinë e Nolit si të ligjshme, sepse sipas tyre kjo qeveri kishte ardhur në pushtet nëpërmjet dhunës dhe rrugeve revolucionare, duke dëbuar nga pushteti personin më të favorshëm sipas interesave ndërkombëtare, Ahmet Zogun. Kuptohet që qëndrimi i shteteve fqinje dhe i Fuqive të Mëdha ishte negativ ndaj qeverisë së re, sepse prekeshin direkt interesat e tyre. Revolucioni Demokratik nuk u mirëprit në Jugosllavi, sepse Beogradit i interesonte një Shqipëri e drejtuar nga A. Zogu, pasi me të kishte patur kontakte të shumta në zgjidhjen e problemeve mes dy vendeve. Një problem që u has me Beogradin gjatë qeverisë noliste ishte problemi i Shën- Naumit. “Çeshtja e Shën –Naumit... ishte një çështje shumë e rëndësishme që u dha tonin marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave në këtë kohë. Ndërsa, për jugosllavët, Shën- Naumi ishte pjesë e lavdisë së Ohrit, qendër e mësimin sllav dhe pjesë e Jugosllavisë ”.[4]

Fitorja e qeverisë demokratike do të sillte në skenën politike shqiptare ardhjen e disa figurave kundërshtarë të Ahmet Zogut, të cilët kishin kontribuar në rrëzimin e tij, bëhej fjalë për H. Prishtinen dhe B.Currin. Këto personalitete përfaqësonin edhe çetat dhe komitetet kosovare që vepronin kundër Jugosllavisë. Siç shihet qarte, A. Zogu dhe Beogradi kishin një qëllim të përbashkët, asgjësimin e figurave të lartpërmendura dhe rikthimin e Zogut në pushtet. Kjo gjë do të realizohej me ndihmën e Jugosllavisë. Madje Jugosllavia nuk e njohu qeverinë e Nolit “për shkak të mbështetjes që i dhanë Nolit, irridentistët e Kosovës dhe ngaqë në përgjithësi besohej se kryeministri i ri ishte vegël e italianëve”.[5] Pakënaqësinë e saj, Jugosllavia e paraqiti në deklaratat e shumta që jepte në shtyp. Ajo deklaronte, se ndryshimet e fundit në Shqipëri nuk japin arsye që të ndiejmë një gëzim të vecantë

për to. Noli i dërgoi një telegram Pashiçit, ku i kërkoi që Jugosllavia e kishte rrugën të hapur, për të hyrë dhe negociuar politikisht me Shqipërinë. Pashiçi u tregua i ftohtë, në qëndrimin që ai mbajti ndaj qeverisë së re. Ne Jugosllavi gjatë kesaj kohe ç'eshtja e njohjes së qeverisë demokratike mund të konsiderohet e mbyllur përfundimisht në kontaktet diplomatike Italo- Jugosllave". [6] Mbreti Aleksandër e akuzoi qeverinë e Nolit, si nxitëse të bandave të armatosura në kufi. Mbreti i Jugosllavisë gjatë një takimi me ministrin Italian Bodrero, i bënte të ditur këtij të fundit që "sdonte gjë tjetër, vec të jetonte në paqe". [7] Jugosllavët dyshonin për qëndrimin e Italisë, por më vonë sipas gazetës Tirana doli teza se: Italia nuk ka gisht në këtë lëvizje. Jugosllavia përdori cdo lloj menyre, për të penguar konsolidimin e pozitës, si brenda vendit ashtu edhe në arenën ndërkombëtare.

Qeveria shqiptare ishte kundër nxitjes së armiqësisë dhe grindjeve me popujt fqinjë. Fan Noli dha një intervistë më 1 shtator 1924 ku sipas korrespondentit të gazetës greke politika në Gjenevë, "Fan Noli theksoi nevojën e bashkëpunimit midis dy vendeve, i cili mund të vendosej me respektimin e të dy palëve". [8] Noli preku dhe problemin e pakicave ku ai bënte të ditur " se pakicat kombëtare në të dy anët e kufirit duhet të jenë jo si një pengim, por si një urë mes dy palëve duke bashkëpunuar miqësisht me njeri-tjetrin". [9] Ministri i jashtëm italian Ninçiq, në bisedimin që pati me të ngarkuarin me punë të Italisë Sola, në 22qershor tha se nuk i bëri efekt paralajmërimi i të ngarkuarit Italian Sola, i cili pohoi se: Roma ishte e gatshme për ta njohur qeverinë shqiptare. Ninçiqi deklaronte në shtyp se njohjen e qeverisë së re, mund ta bënte dhe Jugosllavia, por ajo në të vërtetë nuk mund ta bënte një gjë të tilla.

Pasi problemi shqiptar u bë i njohur në Lidhjen e Kombeve, Ninçiq u mundua ta paraqiste gjendjen e krijuar në Shqipëri, si kaotike dhe të paqëndrueshme. Kjo vinte prej faktit se në Shqipëri ishin ndryshuar shume qeveri dhe se qeveria e Nolit kishte ardhur në mënyrë jo të ligjshme. Në Jugosllavi ndodhën ndryshime politike, në fuqi vjen qeveria liberale e përfaqësuar nga Davidoviçi. Noli shpresonte në ndryshimin e qëndrimit që do të mbante Jugosllavia, me ardhjen e qeverisë së re. Beogradi filloi një luftë kundërshtuese jo vetëm diplomatike por edhe ekonomike. Ajo ndaloi eksportet e drithrave që shkonin në drejtim të Shqipërisë, me preteksin se Jugosllavia vuante për drithëra. Jugosllavia e shprehte hapur qëndrimin kundër qeverisë së Nolit, sepse sipas saj, Shqipëria bënte përpjekje për të nxitur veprimtarinë e bandave të armatosura në kufirin shqiptaro- jugosllav. Noli kërkoi ndihmën e Lidhjes së Kombeve, për t'i dhënë fund pretendimeve jugosllave për të shkelur në kufijtë shqiptar.

Çdo ditë në kufi vinin banda të armatosura, duke shfaqur dhunë dhe genocid mbi popullsinë shqiptare. Një numër i madh agentësh jugosllav, vepronin kundër qeverisë së Nolit dhe mundoheshin, që të vërtetonin pranë Lidhjes së Kombeve se: shqiptarët nuk janë të zotë për të drejtuar një shtet. Ata hodhën idenë se: Shqipëria duhej të merrej nën mbikëqyrjen e Lidhjes së Kombeve ose ajo të copëtohej ndërmjet vendeve fqinje. Mprapa tyre fshiheshin qëllimet grabitqare të Jugosllavisë dhe Greqisë. Beogradi u përpoq të thurte komplete për të rrëzuar Nolin. Ai u bëri thirrje shteteve fqinje në Lidhjen e Kombeve, se ishte për vendosjen e marrëdhënieve të mira mes dy vendeve, pra me Jugosllavinë, por dhe kjo nuk dha rezultat. Me rikthimin në pushtet të Pashiçit në Jugosllavi, marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave u ashpërsuan. Jugosllavia ndoqi një numër të madh fushatash kundër shqiptarëve, si nga pikëpamja diplomatike, por dhe ushtarake. Probleme

u shfaqën në zonat kufitare, ku Jugosllavia mbylli kufirin nga frika se “mos fitorja e demokratëve në Shqipëri ushtronte ndonje influence në minoritetin shqiptar të Jugosllavisë...”. [10]

Konsulli jugosllav i Tiranës mori urdhër nga Beogradi që të mbante kontakte me përfaqësuesin diplomatik të Italisë Markeze di Duraco. Konsulli jugosllav ishte i shqetësuar se mos emigrantët politikë kosovarë, i bënin presion qeverisë shqiptare “në një mënyrë preokupuse për Jugosllavinë”. [11] Noli u mundua që të orientohej drejt Fuqive të Mëdha të cilat mbajtën qëndrime të ndryshme. Anglia nuk e njohu qeverinë e Nolit. Edhe Italia nuk do ta njihje qeverinë demokratike sepse kjo, “e trembur nga programi i qeverisë së tij, si dhe nga mosrealizimi i interesave të saj ekonomike nuk pranoi ta njohë”. [12] SHBA e pershendeti me përzemërsi qeverinë e Nolit por shumë shpejt diplomacia amerikane do të ndryshonte mendim, sepse qeveria e Nolit nuk zgjidhi problemin e dy vrasësve që vranë dy turistë amerikanë në Mamurras, si dhe nuk e favorizoi atë për interesa ekonomike. “Qeveria e vetme që e njohu Nolin, ishte ajo sovjetike”. [13] Orientimi i Nolit drejt një vendi që kishte përfaqësuar komunizmin në Evropë e etiketoi atë si qeveri bolshevike. Fuqitë e Mëdha e dënuan veprimin e Nolit, se ai po përhapte komunizmin në Ballkan dhe më pas do të përhapej me shpejtësi në Evropë. Ata e cilësuan Nolin si: “agjenturë të Moskës dhe Shqipërine si fole të komunizmit”. [14]

Një nga problemet që hasi qeveria demokratike, ishte problemi i kufijve shqiptarë dhe sidomos kufiri verior. Meqëse nuk ishte caktuar kufiri i Veriut të Shqipërisë me Jugosllavinë, ky problem do të diskutohej pas lufte. Një nga pikat më të nxehta kufitare ishte pika e Vermoshit. Zona e Vermoshit kishte qenë prej kohësh pjesë e pandarë e bajorëve të Kelmendit. Kjo zonë ka qenë objekt sulmesh dhe grindjesh të vazhdueshme midis shqiptarëve dhe malazezëve. Gjatë kohës së sundimit turk ishte shënuar në kufi me Malin e Zi, një zonë neutrale, ku në këtë zonë nuk duhet të shkëlqin as shqiptarët dhe as malazezet, por në Konferencën e Ambasadorëve të vitit 1913, Fuqitë e Mëdha vendosën t'i a linin Vermoshin Shqipërisë. Jugosllavia e kundërshtoi këtë vendim, sepse e shikonte zonën e Vermoshit me rëndësi të madhe ekonomike. Konferenca e Ambasadorëve vendosi t'i a caktonte përfundimisht Vermoshin Shqipërisë. Ky vendim solli një acarim nga ana jugosllave, e cila po bënte një seri incidente në kufirin shqiptar. Autoritetet jugosllave ishin të vendosura ta merrnin atë me doemos. Qeveria shqiptare aksionin e saj diplomatik, do ta ushtronte mbi Lidhjen e Kombeve. Gjatë qëndrimit në Gjenevë, Fan Noli mësoi nga qendra se në kufijtë shqiptarë po zhvilloheshin luftëra midis bandave të armatosura jugosllave dhe postave shqiptare të kufirit. Qeveria shqiptare dërgoi përforcime, ajo kërkoi në Lidhjen e Kombeve, që t'i jepeshin fund vuajtjeve të popullit shqiptar, që kishte derdhur gjak në konfliktin shqiptaro-jugosllav për ç'eshtjen e kufijve. Fan Noli në krye të delegacionit, mbajti një fjalim në seancën e parë të Lidhjes së Kombeve, që u mbajt në 3 tetor 1924.

Po në këtë ditë përfaqësuesi jugosllav u bëri të ditur Lidhjes së Kombeve, se nuk kishte qëllim që t'i linin territoret e shumë kërkuara në duart e Shqipërisë. Delegacioni shqiptar kundërshtoi kundër këtyre kërkesave që ishin të padrejta nga ana e Beogradit. Sipas delegacionit shqiptar, forcat ushtarake jugosllave kishin depërtuar në drejtim të kufijve shqiptar dhe se ata ishin duke shkatërruar gjithçka. Sipas tyre, kjo ngjarje nuk duhej të përsëritej më. Jugosllavia dha një version tjetër të ngjarjes, sikur një bandë shqiptarësh u vërsulën mbi fisin malazez të Kucit, ata morën kopetë e lopëve, madje rrëmbyen edhe disa bareshat e tyre.

Jugosllavia përdori edhe akuza të tjera, se bandat shqiptare vepronin në pika të ndryshme të kufirit me Jugosllavinë . Ajo bën përgjegjëse qeverinë e Nolit, për përkeqësimin e gjendjes në kufi. Sipas historiografisë shqiptare dhe asaj të huaj, këto akuza ishin shumë të rënda për Shqipërinë dhe se ato po hiperbolizoheshin me qëllimin e vetëm, se Jugosllavia po përgatitej për një sulm të ri në Shqipëri. Fan Noli mbajti një fjalim të ashpër dhe ironizues, se kjo ngjarje ishte qesharake dhe mosbesuese, e kurditur nga Jugosllavia. Noli ngrinte me të madhe pikëpyetjen, se përse ky fis, duhet të kalonte malin e Vermoshit, kur dihej që kjo zonë ishte objekt mosmarrëveshesh mes dy vendeve fqinje. Pas shumë debatësh dhe diskutimesh problemi i Vermoshit nuk gjeti zgjidhje, sepse ajo do t'i mohojë Shqipërisë nga Ahmet Zogu, i cili do t'i'a premtonte këtë territor Jugosllavisë, në këmbim të ndihmës që ata do t'i jepnin, për t'u rikthyer sërish në pushtet. Një problem tjetër kufitar ishte edhe rasti i Manastirit të Shën – Naumit, edhe pse Konferenca e Ambasadoreve sipas vendimit të saj në 6 dhjetor të vitit 1922, "kishte marr vendimin që manastiri t'i mbetej Shqipërisë".[15]

Kjo gjë kundërshtojë fort nga Beogradi. "Ministri i jashtëm i Francës u tregua i gatshëm të ndërmjetësonte për zgjidhjen e problemit .. pala shqiptare hyri në bisedime duke trajtuar bashkarisht si Vermoshin ashtu dhe Shen- Naunin në kundërshtim me kërkesën jugosllave".[16] Problemi i saj u shqyrtua deri në Gjykatën e Hagës. Qeveria shqiptare caktoi si delegatë në Paris dhe Londër Mehmet Konicen, kurse qeveria e Beogradit caktoi si përfaqësues, ministrin e saj në Paris, Spalaikoviç. Qeveria paraqiti pikëpamjen e vet në memorandumimin e 19 korrikut, i cili u paraqit dy javë më vonë se memorandumimi jugosllav. Te dyja memorandumet, si ai shqiptar dhe ai jugosllav, shprehnin po ato fakte që u bënë të njohura para gjykatës së Hagës në seancën e 23 korrikut nga përfaqësuesit e të dyja palëve shqiptare dhe jugosllave. U diskutuan dy çështje kryesore:

a) Nëse Konferenca e Ambasadorëve ishte i vetmi organ kompetent që caktonte kufijtë shqiptar.

b) Nëse dokumentet e paraqitura nga pala jugosllave, ishin me të vërtetë të reja dhe të panjohura për Konferencën e Ambasadorëve. Që në fillim duhet thene se, të dyja palët kishin ndryshuar qëndrim në lidhje me rolin që duhej të mbante Konferenca e Ambasadorëve për caktimin e kufijve të Shqipërisë. Pala shqiptare ishte duke mbrojtur tezën, se për caktimin e kufijve të saj, kompetente ishte Lidhja e Kombeve, kurse Jugosllavia këtë kompetence ia "vishte" Konferencës së Ambasadoreve. Më vonë të dyja palët, Shqipëria dhe Jugosllavia do të kenë qëndrime të ndryshme ndaj këtyre instancave. Qeveria shqiptare nëpërmjet avokatit të saj Zhidel, mbronte tezën se Konferenca e Ambasadorëve pas lufte ishte e plotfuqishme, për të vendosur mbi kufijtë, pa qenë e lidhur me vendimet e Konferencës së Ambasadorëve të vitit 1913.

Ndërsa qeveria jugosllave u përpoq të argumentonte, se Konferenca e Ambasadorëve nuk kishte kompetenca të plota, sepse ajo nuk kishte të drejtë të ndryshonte vendimin e vitit 1913. Sipas palës jugosllave Konferenca nuk kishte kompetenca ekskluzive, ajo nuk kishte të drejtë të ndryshonte vendimet e vitit 1913. Qeveria shqiptare e kundërshtoi tezën jugosllave, duke mbrojtur pikëpamjen e vendimit të 6 dhjetorit 1922, duke e quajtur atë si përfundimtare. Në ndihmë të pretendimeve jugosllave erdhi qeveria greke. Ajo i kërkoi Gjykatës Ndërkombëtare që të shprehte pikëpamjen e saj në lidhje me çështjen e Shën-Naumit. Kjo kërkesë

u pranua në seancen e 23 korrikut, ku përfaqësuesi grek bëri një deklaratë të shkurtër. Ai u shpreh se: Qeveria greke përputhet plotësisht me argumentat jugosllave që solli Spalaikoviçi. “Argumentet që solli Spalaikovici mbi misionin e Konferencës së Ambasadorëve janë po ato që ka edhe pala greke”. [17] Gjykata Ndërkombëtare vendosi t’ia njoh sërish vendimin e Konferencës së Ambasadorëve të 6 dhjetorit 1922, sepse sipas saj, Fuqite e Mëdha e kanë përsosur detyrën në lidhje me kufirin shqiptaro-jugosllav. Sipas gazetës së Korçës, ajo bënte të ditur në opinionin shqiptar se: “qeverisë së Beogradit nuk i pelqen vija e kufirit e caktuar nga komisioni përkates”. [18] Ky vendim shkaktoi irritim brenda Jugosllavisë, duke e cilësuar atë si të padrejtë. Shtypi jugosllav shpërtheu në një fushatë të gjerë propagandistike në linjën e vjetër të pretendimeve antishqiptare. Çeshtja e Shën Naumit dhe Vermoshit do të rikthehej si objekt diskutimi, kur Zogu do të rikthehej në pushtet.

Shpeshtimi i raporteve Italo- Jugosllave.

Gjatë qeverisjes së Nolit në Shqipëri pati një largim të Beogradit dhe të Romës, të cilët nuk e shihnin me sy të mirë Nolin dhe as nuk donin ta njihnin qeverinë e tij. Dobësimi i marrëdhënieve të Shqipërisë me dy vendet fqinje, Italisë dhe Jugosllavisë, do të intesifikonte raportet mes dy vendeve fqinje të saj, të cilat e shikonin qeverinë e Nolit si kundërshtuese ndaj interesave të tyre. Musolini në fillim u tregua diplomat me Nolin duke u munduar të vendoste marrëdhënie me të, por nuk pati sukses. Roma tregohet e kujdesshme edhe me Jugosllavinë. Ajo ndiqte cdo veprim të saj në lidhje me Shqipërinë. Roma ishte për një ndërhyrje të politikës jugosllave, por kjo gjë do ti jepte prioritet edhe politikës italiane mbi Shqipërinë. Dy shtetet rivale mbi çeshtjen shqiptare duket se po i linin mënjanë mosmarrëveshjet mbi Shqipërinë dhe po hynin në rrugën e negociatave. “Secilës palë i lihet dorë e lirë të veproj me riskun e saj, kurse larja e hesapeve do të behet ne fund”. [19] Aksioni kundër qeverisë demokratike të Nolit filloi me dekretin e këshillit të lartë i nxjerr më 14 nëntor për zhvillimin e zgjedhjeve. “Qarqet drejtuese jugosllave vendosën që të mos lejonin zhvillimin e zgjedhjeve, të cilat mund të rezervonin edhe ndonjë të papritur”. [20] Aksioni kundër qeverisë së Nolit pasqyrohet jo vetëm në burimet arkivore shqiptare, por edhe nga dokumentet e shumta italiane dhe jugosllave. Diplomacia italiane dhe ajo jugosllave i lidhte një gjë e përbashkët, të rrëzonin qeverinë e Nolit. Aksionin kundër qeverisë së Nolit bëhej edhe nga Fuqitë e Mëdha. “Qeveria e Nolit nuk u shiti gjë monopoleve anglo- amerikane, nuk ratifikoi traktatin tregëtar, që kish lidhur me Musolinin, nuk i dha asnjë pëllëmbë tokë Jugosllavisë, nuk i ndoqi dhe nuk i vrau emigrantet kosovare e të tjerë t’arratisur”. [21]

Në politikën e jashtme qeveria shqiptare pati lëkundje. Qeveria angleze nuk e njihnte dhe e luftonte qeverinë e Nolit sepse ajo kishte hyrë në rrugën e negociatave me BS. Shtypi i huaj reaksionar bëri një presion të madh “kundër ardhjes në Tiranë të përfaqësuesit sovjetike fillim i dhjetorit 1924”. [22] Qeveria demokratike i pezulloi marrëdhëniet jo vetem me Anglinë por dhe me mbreterinë Serbo- Kroate –Sllovene dhe me BS. “Në këtë mënyrë qeveria shqiptare mbeti pa asnjë mbështetje dhe te brendëshme”. [23] Në këto kushte Italia dhe Jugosllavia e kishin rrugën të hapur për në Shqipëri për të realizuar sa më shumë synimet e tyre në territorin shqiptar. Në këtë kohë filloi një intesifikim i fortë i raporteve mes tyre. I ngarkuari me punë Sola mori një takim me ministrin e jashtëm jugosllav Niņiqiç. Zhvillimi i drejtpërdrejt i qeverisë së tij ishte në kundërshtim me deklaratat që ai vet kishte marr në qershor për mosndërhyrje në punët e brendshme në Shqipëri. “Qeveria italiane theksonte se nuk kishte ndërmend të dilte si protektore e kësaj apo asaj qeverie”. [24]

Në nëntor në Jugosllavi erdhi sërish qeveria e Pashiçit, e cila e gjeti këtë problem, por sipas shqiptarëve problemi i politikës agresive ndaj Shqipërisë, ka qënë traditë qysh nga e kaluara. Italia luante një lojë të dyfishtë me shqiptarët. “Ajo nuk donte t’i prishte marrëdhëniet me jugosllavët sepse i konsideronte si aleatet më të mirë, por nga ana tjetër ajo kërkonte mandate për Shqipërinë e cila shpresonte se do ta siguronte nga Lidhja e Kombeve”. [25] Intesifikimet jugosllave në kufijtë shqiptarë binin në kundërshtim me interesat italiane, të cilat ishin për ruajtjen e integritetit të saj. Në parlamentin Italian bëhen disa interpelanca lidhur me ngjarjet në kufirin shqiptaro- jugosllav. Qeveria shqiptare nuk kishte dhënë ende përgjigje. Qeveria shqiptare i kërkon Romës ndihmë për blerje municionesh aty nga mesi dhjetorit, por kjo ndihmë nuk i’u dha asaj asnjëherë. Roma heshti ndaj agresionit jugosllav, duke i dhënë pëlqimin në heshtje jugosllavëve, të cilët duhet të vazhdonin intesifikimin e tyre kundrejt Shqipërisë.

Nga kjo situatë e krijuar do të përfitonte edhe qeveria italiane, e cila dukej se po luante mjaft mirë në kurriz të të jugosllavëve, për të dominuar me vonë mbi Shqipërinë. Kjo gjë do të bëhej realitet mbas rrëzimit të qeverisë së Nolit. Ardhja e Ahmet Zogut në pushtet do të ndikonte në ndryshimin e kursit të tij politik duke u orientuar terësisht drejt Italisë.

Konkluzione

Lëvizja e Qershorit erdhi si rezultat i pakënaqësisë së brendshme shqiptare që kishte përfshirë vendin. Dy ishin problemet më të mprehta që shqetësonin vendin. Së pari qeveria zogiste po e orientonte gjithnjë e më tepër Shqipërinë drejt Italisë, duke u dhënë një pjesë të mirë të koncesioneve shqiptare dhe në këtë mënyrë italianët po bëheshin padronë të vërtetë në Shqipëri. Së dyti Ahmet Zogu afrohej edhe me Jugosllavinë, gjë që kërcënonte kufijtë shqiptarë, pasi Jugosllavia ishte e interesuar për kufirin e Shën Naumit dhe Vermoshit. Shqiptarët e ndjenin veten të rrezikuar dhe të kërcënuar nga fqinjët e tyre. Noli i cili dallohet si një nga opozitarët dhe kundërshtarët e qeverisë zogiste bëri përpjekje të vazhdueshme për të rrëzuar qeverinë e tij. Ai u kërkoi ndihmë patriotëve shqiptarë që veproni Brenda dhe jashtë vendit si ; Bajram Curri, Rexhep Shala etj, të cilët të ndërhyenin ushtarakisht për të rrëzuar me forcë qeverinë Zogiste.

Kjo qeveri do të rrëzohet në qershot të vitit 1924, ku Ahmet Zogu do të largohet nga vendi, duke u strehuar në Beograd. Sipas historiografise komuniste lëvizja e Qershorit quhej ndryshe një revolucion, i cili do ti sillte të mira vendit, do të zhdukte feudalizmin, do të sillte reforma përparimtare demokratike, por e parë në kontekstin e politikës ballkanike dhe më gjerë, qeveria e Zogut ishte larguar në mënyrë të paligjshme dhe se po në këtë mënyrë kishte ardhur edhe Noli në pushtet.

Në të vërtetë kjo ishte një levizje që kërkonin qarqet patriotike shqiptare për të ndryshuar stilin dhe mënyrën e të qeverisurisë në Shqipëri. Ata e shikonin qeverisjen e vendit duke e identifikuar me figurën Nolit, i cili ishte edhe një nga figurat më të dashura dhe që kishte fituar popullaritet në Shqipëri. Fuqitë e Mëdha nuk e donin Nolin, sepse ai nuk do tua plotësonte kërkesat e tyre për të zotëruar me koncesionet e tyre në Shqipëri. Sipas tyre Qeveria e Nolit kishte ardhur në mënyrë jo legjitime. Ata nuk vendosë që ta njihnin atë, me përjashtim të BS. Noli erdhi në pushtet nëpërmjet një levizjeje që përfshiu një pjesë të mirë të shqiptarëve. Ardhja në pushtet e Nolit u realizua me anë të një grushti shteti, por idetë e tij ishin përparimtare dhe revolucionare.

BIBLIOGRAFI

- [1] Paskal Milo, "Shqiperia dhe Jugosllavia 1918-1927", Tirane: 1992,233
- [2] Selim Shpuza, "Revolucioni demokratiko- borgjez i qershorit 1924 ne Shqiperi", f.27
- [3] V. Duka, "Historia e Shqiperise (1912-2000)" f.150
- [4] Bernd Fischer, "Mbreti Zog dhe perpiekja per stabilitet ne Shqiperi". Tirane: Cabej, 1999 f. 77
- [5] V. Duka, "Historia e Shqiperise 1912-2000" 149-150
- [6] Arben Puto, "Demokracia e rrethuar" ,Tirane: 8 Nentori 1990, f. 224
- [7] Po aty
- [8] S. Shpuza, "Revolucioni Demokratiko-Borgjez i Qershorit 1924 ne Shqiperi" Tirane: 1959 , f.32
- [9] Po aty
- [10] S. Shpuza, "Revolucioni Demokratiko- Borgjez i Qershorit 1924 ne Shqiperi" f.35
- [11] Po aty f. 35-36
- [12] V. Duka, "Historia e Shqiperise" f.153
- [13] Po aty f. 153
- [14] Akademia e shkencave te RPS, Historia e Shqiperise,vell. 3, Tirane: 1984 , f. 305
- [15] A Puto" Demokracia e rrethuar" f.133
- [16] Kastriot Dervishi,"Historia e shtetit shqiptar 1912-2005" f. 247
- [17] Paskal Milo,"Shqiperia dhe Jugosllavia 1918-1927" f. 282
- [18] "Korca", 30 tetor 1924
- [19] A. Puto " Demokracia e rrethuar"f. 213
- [20] Po aty
- [21] Selim Shpuza, "Revolucioni Demokratiko-Borgjez i Qershorit..." f. 32
- [22] Po aty, f.33
- [23] Selim Shpuza, " Revolucioni Demokratiko- Borgjez i Qershorit...", f. 33
- [24] A. Puto, "Demokracia e rrethuar" f. 216
- [25] Po aty